

Nr. 10439/Prot

Fier më, 25 PS /2025

PROCES VERBAL

Mbledhja e Këshillit të Bashkisë datë 25.09.2025. Sot në sallën e mbledhjeve ora 13:00. Të pranishëm në mbledhje 41 këshilltarë.

Znj. Antoneta Çunaj

Përshëndetje të nderuar këshilltarë! Fillojmë mbledhjen e këshillit bashkiak, meqënëse sekretari ka verifikuar që është krijuar kuorumi i nevojshëm për zhvillimin e mbledhjes.

Pika e parë e rendit të ditës.

Miratimi i rendit të ditës me përmbajtjen si më poshtë:

- 1. Miratimi i Rendit të Ditës.
- 2. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së Këshillit datë 28.08.2025
- 3. Projekt vendim: "Për dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar 6 %, për muajin Gusht 2025".
- 4. Projekt vendim: "Për një ndryshim në VKB nr. 139, datë 23.12.2024, 'Për miratimin e Programit Buxhetor Afatmesëm (PBA) 2025–2027, të buxhetit dhe numrit të përgjithshëm të punonjësve të Bashkisë Fier për vitin 2025', i ndryshuar si rrjedhojë e ristrukturimit të administratës dhe institucioneve vartëse të Bashkisë."
- **5. Projekt vendim:** "Për një ndryshim në VKB nr. 138, datë 23.12.2024, 'Për miratimin e nivelit të pagave të punonjësve të aparatit të Bashkisë Fier, të funksioneve dhe të shërbimeve të Bashkisë Fier".
- 6. Projekt vendim: "Për një ndryshim (rishpërndarje fondesh) në VKB nr. 139, datë 23.12.2024, 'Për miratimin e Programit Buxhetor Afatmesëm (PBA) 2025–2027 dhe të buxhetit të Bashkisë Fier për vitin 2025', i ndryshuar për efekt të ristrukturimit."
- 7. **Projekt vendim:** "Për Miratimin e Projekt Dokumentin të Programit Buxhetor Afat Mesëm (PBA) 2026-2028 të Bashkisë Fier", Faza e II, (i pandyshuar)"

- **8. Projekt vendim:** "Për miratimin e krijimit të Njësisë Shpenzuese dhe ndryshimin e emërtimit të disa Njësive Shpenzuese, të Bashkisë Fier.
- 9. Projekt vendim: "Për dhënien e miratimit për kalimin në administrim të Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural të pasurisë nr. 86/18 zk. 3031 e llojit "ullishte" me sipërfaqje 187 800 m2, e ndodhur në territorin e Njësisë Administrative Portëz Bashkia Fier, tokë shtetërore me origjinë nga ish NB Frutore", pronë në përdorim të Bashkisë Fier"
- 10. Projekt vendim: "Për ndreqjen e një gabimi material në Vendimin e Këshillit të Bashkisë Nr.61, datë 23/06/2025 "Për miratimin e përfundimit të procedurave të privatizimit të banesave të cilat kanë mbetur pa u regjistruar në Agjencinë Shtetërore të Kadastrës, Drejtoria Vendore Fier për shkak të lidhjes së kontratave para noterit".
- 11. Projekt vendim: "Për një saktësim në VKB Nr.64, datë.23/06/2025 të Këshillit të Bashkisë Fier "Për miratimin e tabelës me të dhënat e listës emërore të pronave dhe pronarëve, që do të shpronësohen për interes publik, për pasuritë e paluajtshme pronë private, që preken nga realizimi i projektit "Për zgjerimin e sheshit të stacionit zjarrfikës, të ndërtuar dhe financuar nga PNUD(UNDP), vlerësim paraprak me qëllim mbulimin e vlerës paraprake të shpronësimit për interes publik nga Buxheti i Bashkisë Fier, për vijimin e procedurave të shpronësimit për interes publik".
- **12. Projekt–vendim**: "Për miratimin e implementimit të Projektit Strategjik me titull ''ARIADNE'', në kuadër të Instrumentit të Para-Anëtarësimit (IPA III), Programi i Bashkëpunimit Ndërkufitar Greqi–Shqipëri 2021–2027."
- **13.** Informacion Këshillit : "Mbi Raportin e Monitorimit për zbatimin e Buxhetit për 4 -mujorin e II-të të vitit 2025" të Bashkisë Fier".
- **14.** Diskutime dhe komente.

Znj. Antoneta Çunaj

Materialet besoj se ju kanë ardhur të gjithëvë në mënyrë elektronike. Kështu që hedhim ne votim rendin e ditës . Kush është dakort ?

Pro 41 vota.

Kundra s'ka.

Abstenim s'ka.

Miratohet.

Znj. Antoneta Çunaj

Përveç rendit të ditës me përmbajtjen e mësipërme, kemi edhe dy pika shtesë.

2 11

M

Pika e parë shtesë e rendit të ditës.

Projekt -vendim: "Për trajtimin me ndihmë shtetërore financiare të familjes së shtetasit Florjan Hoxhaj, lagjja "Liri Gero", Njësia Administrative nr.2, i dëmtuar nga zjarri i datës 13.09.2025.

Pika e dytë shtesë e rendit të ditës.

"Për autorizimin e ekzekutivit të Bashkisë Fier të nënshkruaj marrëveshjen e bashkëpunimit për administrimin e përkohshëm të objektit "Depo uji 200 m³, Mbrostar Ura" nga "Shoqëria Rajonale e 'Ujësjellës-Kanalizime Fier' Sh.A.

Znj. Antoneta Çunaj

Kush është dakort me futjen në rendin e ditës të dy pikave shtesë që sapo lexova?

Pro 41 vota.

Kundra s'ka.

Abstenim s'ka.

Miratohet.

Pika e dytë e rendit të ditës.

Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së këshillit të datës 28.08.2025

Znj. Antoneta Çunaj

Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së datës 28.08.2025. Materiali u është dorëzuar të gjitha forcave politike, është firmosur prej tyre. Kush është dakort ?

Pro 41 vota.

Kundra s'ka.

Abstenim s'ka.

Miratohet.

Pika e tretë e rendit të ditës

Projekt -vendim "Për dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar 6 %,për muajin Gusht 2025"

Znj. Antoneta Çunaj

Kush e do fjalën nga administrata?

Znj.Suela Prifti

Përshëndetje! Nga fondi i kushtëzuar i ndihmës ekonomike 6% për muajin Gusht përfitojnë gjithsej gjithsej 37 familje me një fond prej 210,644 (dyqind e dhjetemije e gjashteqind e dyzete e kater) leke.

Gjithsej kanë dalë 2(dy) familje për arsye të mbarimit të afatit të riaplikimit në sistem. Familjet që kanë dalë janë: 1.Alma Pajo Bushaj NjAdm. Nr.3 dhe 2. Eleni Thanas Nako NjAdm. Qender. Janë futur 7(shtatë)familje si më poshtë:

3

1

h

1.	FI)	NjAdm. Nr.2
2.	Li		NjAdm. Nr.2
3.	Ja		NjAdm. Nr.4
4.	Ві		NjAdm. Nr.4
5.	O		NjAdm.Libofshe
6.	H		NjAdm.Libofshe
7.	Aı		NjAdm.Qender
8.	Re		NjAdm.Portez

Nga verifikimi që është bërë nga administratorët social është parë që gjendja e tyre financiare është e dobët prandaj janë bërë pjesë e kësaj skeme.

Znj. Antoneta Çunaj

Kush është dakort?

Pro 41 vota

Kundra s'ka

Abstenim s'ka

Të gjithë pro, miratohet.

Pika e katërt e rendit të ditës.

Projekt – vendim: "Për një ndryshim në VKB nr. 139, datë 23.12.2024, 'Për miratimin e Programit Buxhetor Afatmesëm (PBA) 2025–2027, të buxhetit dhe numrit të përgjithshëm të punonjësve të Bashkisë Fier për vitin 2025', i ndryshuar si rrjedhojë e ristrukturimit të administratës dhe institucioneve vartëse të Bashkisë."

Znj. Antoneta Cunaj

Është mbledhur komisioni përkatës për këtë pikë të rendit të ditës?

Z.Kreshnik Dapi

Komisioni është mbledhur më datën 19.09.2025 në orën 12;00.Ka marrë në shqyrtim të gjitha pikat që janë pjesë e veprimtarisë së këtij komisioni duke filluar nga pika 4,5,6,7,8,9,10 dhe 12. Komisioni është njohur me materialin, ka diskutuar me personat përgjegjës që janë drejtuesit përkatës të Bashkisë dhe marrë një vendimmarrje pro për të gjitha pikat e mësipërme.E ftojmë këshillin të miratojnë pikën 4 dhe pikat në vazhdim.Faleminderit!

Të flasi përfaqësuesja e bashkisë.

Znj. Antoneta Çunaj

Kushe e do fjalën në lidhje me këtë pikë të rendit të ditës?Po inxhinier.

Z.Ilia Fili

V

Është një nga pikat më të debatueshme. E lexova materialin me shumë vëmendje.Konstatova që nga ana e administratës së bashkisë është përpjekur për tu argumentuar shtimi i numrit të punonjësve ekzaktësisht 88 punonjës shtesë. Pse po kërkohet ky shtim tani?I kërkoj ndjesë kolegëve për ngritjen e tonit, por ky është shqetësimi i një këshilltari i cili konstaton se si abuzohet me taksat e qytetarëve. Totali përfshin vendet vakant qoftë në administratën e bashkisë qoftë dhe në ndërrmarjet vartëse të saj. Për mua kemi të bëjmë thjesht me hapje vendesh të reja pune, pa testuar se çfarë kriteresh duhet të plotësojnë kandidatët që konkurojnë për këto vende. Natyrisht unë nuk mendoj që kjo kërkesë vjen thjeshtë për të plotësuar pretendimet dhe kërkesat e egos dhe të lakmisë për vende të përshtatshme dhe më të mira pune, për shpërblime mbas fushatës zgjedhore. Pasi keni përcaktuar emrat, ju keni përcaktuar dhe numrin e punonjësve që doni të shtoni në organikë.Ju e dini shumë mirë që unë në këtë këshill qëndrimet I kam mbajtur jo politike, besoj që e keni konstatuar këtë gjë, dhe mbi të gjitha e konstatuat atë kur unë isha i pari që shtrova domozdoshmërinë të vlerësimit të institucionit të kryetarit të bashkisë .Isha ndër të parat që pranova dhe votova pro rritjes së pagave të punonjësve në institucionin e bashkisë, sepse e quajta të drejtë dhe e dini që si pasojë e kësaj ka patur një furtunë të jashtëzakonshme politike mbi mua?Për ata që nuk e kuptonin pasi ata që më kuptonin natyrisht që më përkrahën. E thashë këtë për të treguar që nuk kam gjykuar në aspektin politik, por në aspektin qytetar, edhe në rastin e sotëm, dhe gjithë ky material që keni pregatitur është thjeshtë për të kënaqur egot dhe lakmitë e njerëzve tuaj të cilët pretendohet që kanë dhënë kontribute të mëdha në fushatë.

Znj. Antoneta Çunaj

Më fal inxhinier që po të ndërpres, sepse dua të them diçka. Asnjëherë më parë nuk ju kam dëgjuar të flisni në lidhje me këto pretendime që po ngrini sot. Sot po flisni për këtë fakt. Për sa i përketë pjesëmarrjes dhe pretendimit që ju ngrini për pjesëmarrjen e punonjësve të bashkisë në fushatë, ne nuk kemi asnjë lloj informacioni nga institucionet që kanë bërë monitorimet për pjesëmarrje të punonjësve në fushatë. Dhe ju si përfaqësues të opozitës nuk keni sjellë qoftë edhe një rast të ndonjë punonjësi të bashkisë të përfshirë në fushatë.

Z.Ilia Fili

Zonja kryetare mos më ndërprit fjalën. Ajo që është e vërtetë është e vërtetë.

Znj. Antoneta Çunaj

Po pse pikërisht sot, kur zgjedhjet kanë tre-katër muaj që kanë mbaruar .

Z.Ilia Fili

Sepse mua sot më erdhi në tavolinë projekt vendimi.

Znj. Antoneta Çunaj

Jo, jo .Për shkeljet e pretenduara nga ana juaj në periudhat e mëparëshme duhet ti denonconi në kohë dhe jo ti kërkoni sot. Kur ky projekt-vendim i ardhur sot me sa jam informuar unë nga administrata ka të bëjë me ndarjen dhe krijimin e disa ndërrmarjeve si psh; 'varrezat'' do të bëhen ndërrmarje më vete dhe duan një administratë dhe fuqi punëtore.Për sa i përket të tjerave do të dëgjojmë përfaqësuesin e bashkisë që do të japi sqarimet përkatëse, por nuk jam dakort që ta politizosh këtë problem.Sipas mendimit tim dhe duke parë dhe projekt vendimin pjesa më e madhe e këtyre shtesave që janë kërkuar nga sektorët apo drejtoritë përkatëse do të jenë personel që do ti shërbejnë këtij komuniteti.Mgjth është e drejta juaj që të flisni dhe të jepni mendimin tuaj.

Z.Ilia Fili

10

A

Unë sygjeroj Pse duhet të jetë një drejtor I përgjithshëm për tre drejtori? I.e të jetë një drejtor i përgjithshëm për një drejtori. Pse të kemi vetëm dy apo tre nënkryetarë, le të kemi një nënkryetarë për çdo drejtor të përgjithshëm dhe raportimi tek kryetari do të vejë ideal, specialisti do të raportojë tek drejtori i tij, drejtori do ti raportojë drejtorit të përgjithshëm, drejtori i përgjithshëm do ti raportojë nënkryetarit dhe nënkryetari do ti raportojë kryetarit. Kjo ishte ajo që kisha për të sygjeruar. Unë po e shpreh me zë që do të votojë kundra këtij materiali për gjithë ato që thashë më sipër.

Znj. Suela Prifti

Më fal zonja kryetare, mund të bëj një sqarim për të gjithë ata që na dëgjojnë?

Znj.Antoneta Çunaj

Po

Znj. Suela Prifti

Me propozimi të KM-së po bëhet ristrukturimi I të gjitha bashkive, gjithashtu bazuar dhe në kërkesat e ardhur nga të gjithë drejtorët e drejtorive të bashkisë për shtim të fuqisë punëtore, është parë e arsyeshme që të rritet fuqia punëtore dhe numri mesatar maksimal është rreth 88 punonjës dhe nuk është e thënë që kjo shifër do të ezaurohet e gjitha.Risi e këtij ristrukturimi, është shtimi i një nënkryetari nga tre në katër, sekretari i përgjithshëm mbetet siç ka qënë, pesë drejtori të përgjithsme të cilët do të krijohen dhe kjo në mënyrë që të ndahen drejtoritë midis drejtorive të përgjithëshme.Një drejtor i përgjithshëm do të mbulojë tre katër drejtori në varësi të ndarjes që është planifikuar dhe do të bëhet. Drejtoritë e përgjithshëm do të jenë si më poshtë:

Drejtoria e Përgjithme e Menaxhimit Financiar, Drejtoria e Përgjithëshme e të Ardhurave, Drejtoria e Përgjithëshme e Administrimit, Drejtoria që lidhet me politikat Social-Kulturore dhe Sportive, Drejtoria e Zhvillimit Urban dhe Menazhimit të Infrastrukturës Publike. Kjo bëhet me synim që të behet një riorganizim sa më i mirë i punës duke qënë se ngarkesa dhe volumi është i madh dhe jo të gjitha gjërave ju kthehet përgjigja në kohë reale. Duke qënë se ka shumë ngarkesë nuk arrihet tu shërbehet qytetarëve siç duhet, për këtë është parë e nevojshme një gjë e tillë, plus që është parë në të mirë të komuniteteit pas kërkesave të tyre, të miratohet krijimi i një njësie të re shpenzuese që është ndërrmarrja e varrezave publike me qëllim që të mirëmenaxhohet, të administrohet dhe do të ketë buxhetin e vet. Ajo do të jetë drejtori më vete, e pavarur, por gjithmonë në varësi të bashkisë, dmth buxheti i saj do të mbulohet nga bashkia. Të ardhurat që ata do të sigurojnë do ti përdorin për të kryer shërbimet për të cilat komuniteti do të kenë nevojë.

Znj. Antoneta Cunaj

Kush e do fjalën?

Z.Kreshnik Dapi

Zonja kryetare, në përgjigje të fjalës së kolekut Ilia Fili, do të shtoja në radhë të parë në cilësinë e kryetarit të grupit PSD. Ne jemi njohur me materialin dhe materiali sjell shumë risi, është një punë e mrekullueshme e bërë nga personat përkatëse, të cilët unë i përshëndes, sjell një fuqizim të administratës së bashkisë, pse jo rritjen e numrit të punonjësve që edhe ne si parti edhe më të vogla e kemi kërkuar herë pas here. Me sa dimë ne është hapur një portal, ku prej muajsh po aplikojnë me qindra djem dhe vajza, për vendet vakande dhe për pjesën politike që Ilia preku,bëjnë shumë mirë që bashkitë ashtu si edhe institucionet e tjera, kanë një drejtim edhe politik, dhe më vjen mirë që kryetari i PS, njëherësh

õ

1 .

VVI

Kryeministër i Shqipërisë, e ka filluar tashmë reformimin e plotë të bashkive ku ai ka parë probleme, çka do të thotë edhe në bashkinë e Fierit, dhe ne të gjithë si këshilltarë duhet që ta përkrahim dhe ta përshëndesim.Unë në cilësinë e sekretarit të Komisionit të Ekonomisë,por edhe të kryetarit të Kryesisë, do ju lutesha dhe këshilloja që ta kalonim në votim.

Znj. Antoneta Çunaj

Unë inxhinierin nuk e ndërpreva, por do ju sygjeroja të gjithë këshilltarëve të flasin në diskutimet e tyre për pikat e rendit të ditës pasi çdo fjalë e bërë jashtë rendit të ditës nuk hidhet në procesverbal. Po Z.Çuko

Z.Arben Çuko

Dhe ne jemi dakort me numrin e rritjes së punonjësve por do të shtoja që më e udhës është siç e kemi theksuar dhe herë tjetër, rritja e nivelit të pagës, sepse kjo do të ndikonte që këta persona ta bënin punën shumë herë më mirë. Përsa i përket pretendimeve që ngriti goleku për punësimet që bëhen gjatë dhe pas fushatës, ne e dimë se si bëhen këto punësime, por në përfundim ajo që do të thosha është se ne si grup do ta votonim këtë projekt vendim nëse do të shoqërohet me rritjen e nivelit të pagës, duke patur parasysh se ne e dimë se sa të ulëta janë nivelet e pagave për punonjësit në ndërrmarjet e bashkisë.

Znj. Antoneta Çunaj

Unë e di që niveli i pagave është i përcaktura me ligj dhe nuk mund të dilet jashtë kritereve ndaj edhe përfaqësuesit e bashkisë nuk mund të dalin jashtë kritereve sepse përndryshe penalizohen, në përputhje me këto kritere bëhen pagat.Do ndonjëri fjalën?

Z.Endri Jaupaj

U bë mbledhja e tretë radhazi që kryetari mungon. Nuk do të ishte më e udhëz që dhe ai të ishte pjesë e këtyre diskutimeve, ose nëse e ka të justifikuar mungesën, mirë do të ishte që të na thuhej, sepse në këto diskutime me kaq tension që po bëhen do të ishte më e udhës që ai të ishte prezent. Ose të japi dorëheqjen si shokët dhe do të ishte akoma më mirë për atë pastaj.

Znj. Antoneta Çunaj

Më fal një minutë Z.Jaupaj. Së pari nuk e detyrojmë ne kryetarit që të vijë në mbledhje. E dyta ne jemi të detyruar ta njoftojmë për mbledhjen dhe e treta nuk është mirë që ti si anëtarë këshilli ti thuash këto kur ai nuk është prezent. Tani i lëmë këto diskutime jashtë rendit të ditës. A ka njëri tjetër për të diskutuar në lidhje me këtë pikë të rendit të ditës? Jo. Atëherë e hedhim në votim. Kush është pro?

Pro 36 vota

Kundra 5 vota.

Abstenim s'ka

Miratohet.

Pika e pestë e rendit të ditës.

Projekt – vendim: "Për një ndryshim në VKB nr. 138, datë 23.12.2024, 'Për miratimin e nivelit të pagave të punonjësve të aparatit të Bashkisë Fier, të funksioneve dhe të shërbimeve të Bashkisë Fier".

Znj. Antoneta Çunaj

7

M



Materialin e keni. Ky ëmaterial është si rrjedhojë e pikës 4 të rendit të ditës. Ka ndonjë këshilltarë dëshirë të diskutoj rreth kësaj pike psai komisioni është mbledhur siç e tha edhe sekrati i komisionit më parë? Nuk ka ,atëherë e hedhim në votim Kush është pro?

Pro 38 vota

Kundra 3 vota.

Abstenim s'ka

Miratohet.

Pika e gjashtë e rendit të ditës.

Projekt – **vendim:** "Për një ndryshim (rishpërndarje fondesh) në VKB nr. 139, datë 23.12.2024, 'Për miratimin e Programit Buxhetor Afatmesëm (PBA) 2025–2027 dhe të buxhetit të Bashkisë Fier për vitin 2025', i ndryshuar për efekt të ristrukturimit."

Znj.Antoneta Çunaj

Materiali ju ka ardhur. Të flasi fillimisht përfaësuesi i bashkisë pastaj këshilltarët që duan të flasin.

Znj.Pranvera Cina

Përshëndetje të gjithëve! Në zbatim të vendimit për riorganizimin e njësive bazë dhe për plotësimin e kapaciteteve administrative të Bashkisë Fier, është kryer një rishikim i strukturës administrative dhe një rishpërndarje e fondeve buxhetore, me synim rritjen e efiçencës, standartizimin e shërbimeve dhe përmirësimin e mbulimit të nevojave reale të qytetarëve. Ky proces ka kërkuar edhe një rishërndarjesh fondesh pasi ka shtim të numrit të punonjësve në disa sektor kyç, drejtori dhe ndërrmarje. Ndryshimet janë parashikuar : Kalimi i sektorit të higjenës në ndërrmarjen e pastrimit, kalimin e sektorit të varrezave si ndërrmarrje më vete dmth i hiqet ndërrmarrjes së gjelbërimit dhe kalon më vete, kalimi i rojeve nga QEA-Bashkia Fier dhe ndërrmarrjet e tjera dhe unifikimi ose bashkimi me drejtorinë e Policisë Bashkiake. Shtimi i numrit të punonjësve në total është 88 punonjës, ku përfshihen drejtorët e përgjithshëm, përgjegjësat e sektorit, specialistë, staf mbështetës, punonjës të tjerë që janë të domozdoshëm për mbulimin e detyrave të reja dhe të zgjeruara. Për të realizuar këtë riorganizim, është parashikuar rishpërndarja e fondeve si më poshtë:

- 1.Kemi pakësim plani në total 50 milion 283 mijë e 660 lekë e cila do të reduktojë fondin rezervë të Bashkisë Fier me vlerën 14 milion e 350 mijë.
- 2.Kemi kalim të rojeve siç thamë nga QEA në drejtorinë e Policisë Bashkiake dhe kemi pakësim të fondeve nga QEA me 10 milion e 282 mijë e 776 lekë për paga dhe 1 milon e 717 mijë për sigurimet shoqërore. Gjithashtu kalimi i rojeve të ndërrmarjes së Ujitjes dhe kullimit pranë Bashkisë Fier do të sjelli një rishpërndarje fondesh në vlerën e 1 milion 228 mijë e 500 lekë për paga dhe 205 mijë për shpenzime sigurime shoqërore.
- 3.Largimi i dy sektorëve të Higjenës dhe Varrezave nga ndërrmarja e Gjelbërimit, sjell lirimin e fondeve që nuk do të përdoren nga kjo ndërrmarje konkretisht 11 milion 568 mijë e 123 lekë për shpenzimesh pagash dhe 1 milion 930 mijë e 877 lekë për shpenzime sigurime shoqërore dhe 9 milion shpenzime operative. Kemi të njëjtën shtesë plani me të njëjtën vlerë që pakësohen me po atë vlerë dhe shtohen që janë 50 milion 283 mijë e 660 lekë.

}

M

) "

Gjithashtu kemi dhe një rishpërndarje fondesh për klubin Shumësportesh Apollonia. Kjo vjen bazuar në kërkesën që ka bërë Klubi Shumësportesh Apollonia. Buxheti që është miratuar në fund të vitit paraardhës me VKB nr .139, ka qënë i shpërndarë 56% për pagat dhe sigurimet, 24% për mallra dhe shpenzime operative dhe 19 % për pagesë sportistësh dhe trainerash të disiplinave të ndryshme. Nevojiten për të funksionuar sa më mirë, dhe për të përmbushur detyrat që ky klub ka, nevjitet një shtesë buxheti në vlerën 6 milion lekë e cila do të merret, pra do të pakësohet, nga shpenzimet operative të Bashkisë Fier.

Znj. Antoneta Çunaj

Dëshiron ndokush fjalën nga anëtarët e këshillit? Po inxhinier.

Z.Ilia Fili

Në vijim të diskutimeve që po bëhen unë pyes:A do ta zbatojë bashkia ligjin për kompesimin e pagave në përputhje me inflacionin që ka nxjerr INSTATI? A ka ndonjë vit që rri inflacioni zero?Pse e bëj këtë pyetje, sepse po të shikojmë materialin në zërin e pagave, janë të njëjtat vlera për vite me radhë. A nuk duhet të ndryshonin pagat të paktën me minimumin e inflacionit të detyrueshëm. E kam ngritur zërin disa herë për këtë problem, por ju vazhdoni në të njëjtën rrugë. Periodikisht prognoza nuk arrihet në këtë formë. Prognoza ka rregullat e saj.

Z.Endri Jaupaj

Të futen në privat o profesor tani. I ka vajtur 2 milion lekë rroga guzhinierit. Të ikin nga administrat të shkojnë në privat.Pagat janë në zbatim të ligjit, të japin dorëheqjen nëse nuk janë të kënaqur me këto paga.Kaq e thjeshtë është.Të vijnë atje tek mua se i paguaj unë më shumë.

Znj. Antoneta Çunaj

Me sa di unë, inflacionin nuk e llogarit financa e bashkisë, por vjen e llogaritur nga struktura qëndrore, sepse nëse do ta bënte finaca e bashkisë këtë gjë do të shkelte ligjin dhe do të konsiderohej vepër penale. Kush është dakort për miratimin e kësaj pike?

Pro 37 vota

Kundra 4 vota.

Abstenim s'ka

Miratohet.

Pika e shtatë e rendit të ditës.

Projekt – vendim: "Për Miratimin e Projekt Dokumentin të Programit Buxhetor Afat Mesëm (PBA) 2026-2028 të Bashkisë Fier", Faza e II, (i pandyshuar)"

Znj. Antoneta Cunaj

Në lidhje me këtë materiali të flasi shkurtimish përfaqësuesi i bashkisë sepse materiali u është paraqitur këshilltarëve.Po Znj.Cina

Znj.Pranvera Cina

A

Jemi në fazën e dytë të miratimit të buxhetit afatmesëm 2026-2028 dhe nuk ka ndryshim nga faza e parë. Kalojmë për miratim me të njëjtat vlera tavanesh, me të njëjtat shpenzime për programet buxhetore, nuk kemi asnjë lloj ndryshimi.

Znj.Antoneta Çunaj

Kush e do fjalën? Nuk ka asnjë atëherë e hedhim në votim. Kush është pro?

Pro 38 vota

Kundra 3 vota.

Abstenim s'ka

Miratohet.

Pika e tetë e rendit të ditës.

Projekt – vendim: "Për miratimin e krijimit të Njësisë Shpenzuese dhe ndryshimin e emërtimit të disa Njësive Shpenzuese, të Bashkisë Fier.

Znj.Antoneta Çunaj

U diskutua më parë në pikën 4 të rendit të ditës. Kush e do fjalën nga anëtarët e këshillit ?

M.q.s nuk ka diskutime e hedhim në votim.Kush është pro?

Pro 38 vota

Kundra 3 vota.

Abstenim s'ka.

Miratohet.

Pika e nëntë e rendit të ditës.

Projekt – vendim: "Për dhënien e miratimit për kalimin në administrim të Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural të pasurisë nr. 86/18 zk. 3031 e llojit "ullishte" me sipërfaqje 187 800 m2, e ndodhur në territorin e Njësisë Administrative Portëz Bashkia Fier, tokë shtetërore me origjinë nga ish – NB Frutore", pronë në përdorim të Bashkisë Fier"

Znj. Antoneta Çunaj

Materiali ju ka ardhur. Kush e do fjalën nga përfaqësuesit e bashkisë?Po Arbion.

Z.Arbion Behari

Përshëndetje të gjithëve!Materiali që ju është paraqitur për miratim është hartuar mbi bazën e një kërkese të ardhur nga Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, e cila kërkon miratimin për vijimin e kalimit në pronësi dhe në administrim të kësaj ministrie të të pasurisë me nr. 86/18 zk. 3031 e llojit "ullishte" me sipërfaqje 187 800 m2, e ndodhur në territorin e Njësisë Administrative Portëz Bashkia Fier, tokë shtetërore me origjinë nga ish – NB Frutore. Duke qënë se pronat shtetërore me origjinë nga ish ndërrmarjet shtetërore, dhe duke ju referuar ligjit të bujqësisë por edhe në zbatim të VKM-së së dalë në zbatim të ligjit, administrohen nga kjo ministri, Nga një komunikim që kemi patur me këtë ministri për një projekt që kanë ata, ndërtimin e disa

10

/K

pikave për përpunimin e produkteve bukqësore, i kanë kërkuar bashkisë Fier ti sugjeronin disa prona, ku ata mund të ndërtonin këto pika. Një ndër pronat që ne i kemi sugjeruar nga komunikimet që kemi patur ka qënë pikërisht edhe kjo pronë . Ndodhur në kushtet kur dhënia e miratimit për kalimin në pronësi të kësaj prone në administrim të Ministrisë së Bujqësisë, bazuar në neni 54 pika 10 për qeverisjen vendore është kompetencë e këshillit bashkiak, i jemi drejtuar këshillit për të dhënë miratimin.

Znj.Antoneta Çunaj

A ka ndonjë nga këshilltarët që do të flasi?Po Gëzim.

Z.Gëzim Hajdëraj

Kam një pyetje.Çfarë pikash ju ka sjellë ministria dhe a keni ju projekt të sjellë nga ministria për zhvillimin e kësaj prone?Sa është sipërfaqja e këtyre pikave që ata kërkojnë të ndërtojnë?A i ka futur ministria për zgjidhje këto pika, çfarë fondi kërkojnë këto pika sepse ministria nqs do ta marri do ta marri. Por nqs duhet ta marri nëpërmjet këshillit duhet të dimë se për çfarë i duhet ministrisë gjithë kjo sipërfaqe sepse janë 187 mijë m², nuk janë 2 mijë m², është një sipërfaqe e madhe.Nqs ju niseni që është ministri dhe i di ajo këto punë, mua nuk më intereson kjo gjë. Mua më interesojnë interesat e bashkisë pra interesat e qytetit të Fierit. Unë mendoj se duhet të jemi të kujdesshëm në këtë pikë sepse në çdo mbledhje ne vetëm po heqim prona të bashkisë dhe po ja kalojmë jo individëve , ministrisë, sportit etje. Bashkisë vetëm po i zerohen pasuritë. Unë do të doja një përgjigje sqaruese lidhur me fazat që ministria parashikon në lidhje me këto pika.

Z.Arbion Behari

Do ta jap shpjegimin për këtë rast. Ministria nuk e ka kërkuar administrimin e kësaj prone vetëm në bazë të këtij projekti por e ka kërkuar në bazë të ligjit sepse administrimi I pronave që janë me origjinë nga ish NB-të I takon ministrisë së Bujqësisë. Ndërkojë bashkia admininistron dhe ka në pronësi vetëm tokat bujqësore që janë me origjinë nga ish kooperativat bujqësore. Duke qënë se administrimi I pronave të NB-ve i takon ministrisë, dhe duke qënë se edhe ne kemi bërë një propozim që ata mund ta përdorin këtë pronë për interesat e veta, ata na janë drejtuar në bazë të ligjit neve që e kërkojnë. Duke qënë se bashkia nuk e administron dot këtë pronë, duke qënë se bashkia administron dhe ka në pronësi sikurse e thashë dhe më lartë vetëm tokat bujqësore që janë me origjinë nga ish kooperativat bujqësore.

Z.Gëzim Hajdëraj

Atëherë shtrohet pyetja: Nqs në bazë të ligjit, siç thoni ju, pasi unë nuk e njoh këtë dispozitë ligjore dhe po e marrë si të mirëqënë, pse duhet atëherë këshilli bashkiak ta marri këtë vendim.Ne nuk marrim vendime nqs ligji ka parashikuar që ata kanë të drejtë, nqs e kemi ne të drejtën atëherë nuk vendos ministria por vendosim ne. nuk kemi nevojë që ministria të na hapi rrugën as që të na thotë se çfarë do të bëjmë. Nqs është kompetencë e ministrisë në bazë të ligjit atëherë nuk kemi nevojë që ta shqyrtojmë ne.

Z.Arbion Behari

Ta shpjegoj dhe këtë rast. Kjo pronë është pronë e ish komunës Portëz që sot është në administrim të Bashkisë Fier. Në kohën që është bërë inventari, ata e kanë çuar pjesë të inventarit të tyre por që realisht nuk duhet të ishte pjesë e inventarit të ish komunës Portëz pasi në bazë të ligjit, ish komunat administronin vetëm tokat bujqësore që ishin me origjinë nga ish kooperativat. Për këtë arsye e kërkojmë ne sot miratimin e këshillit pasi në të kundërt nuk e sillnim për miratim.

11 11 11

Z.Gëzim Hajdëraj

Nqs ka gabime teknike që i është kaluar bashkisë në mënyrë të parregullt ashtu siç thoni ju, nuk kemi pse të marrim vendim ne por le të vejë në ASHK dhe të zgjidhet atje, të thuhet që është bërë një gabim teknik dhe ti kalohet ministrisë dhe nuk ka nevojë fare për vendim marrje të këshillit. Nqs në të kundërt e kemi ne kompetencë, atëherë arsyetimi i bërë nga ana juaj nuk qëndron fare. Kështu që unë në parim jam kundra kësaj pike.

Z.Ilia Fili

Që të jem I qartë është kërkesë e bashkisë drejtuar ministrisë apo është kërkesë e ministrisë që do të marri pronën e saj?

Znj.Antoneta Çunaj

Sipas materialit të ardhur, kjo tokë është tokë e ish NB-së frutore. Në administrim të bashkisë futen vetëm ato prona që janë me origjinë nga ish KB. Ish pronat që kanë qënë të ish NB-ve duhet të jenë në administrim të Ministrisë së Bujqësisë. Gëzimi mendon që është një gabim material që është bërë në kadastër dhe të rregullohet teknikisht, por përfaqësuesi i bashkisë deklaron që ky gabim nuk mund të rregullohet teknikisht por duhet vendimmarrja e këshillit prandaj na kanë paraqitur këtë material. Kjo është situate. Ka diskutime të tjera? Ta hedhim në votim. Kush është pro?

Pro 37 vota

Kundra 3 vota.

Abstenim 1 votë.

Miratohet.

Pika e dhjetë e rendit të ditës.

Projekt – vendim: "Për ndreqjen e një gabimi material në Vendimin e Këshillit të Bashkisë Nr.61, datë 23/06/2025 "Për miratimin e përfundimit të procedurave të privatizimit të banesave të cilat kanë mbetur pa u regjistruar në Agjencinë Shtetërore të Kadastrës, Drejtoria Vendore Fier për shkak të lidhjes së kontratave para noterit".

Znj. Antoneta Çunaj

Të flasi përfaqësuei i bashkisë. Po Znj.Kapllanaj

Znj. Esmeralda Kapllanaj

Bëhet fjalë për një gabim material për Z.Tajar Xhevit Toska. Është bërë një gabim material ku sipas kartelës kemi të bëjmë me struktturë 2+1 dhe gabimisht është shënuar në vendimin që kemi marrë 1+1. Për efekt të zbatueshmërisë së veprimeve midis qytetarit dhe bashkisë duhet korrigjuar ky gabim material.

Znj. Antoneta Çunaj

E hedhim në votim.Kush është pro?

Pro 40 vota

Kundra 1 votë.

12



Abstenim s'ka.

Miratohet.

Pika e njëmbëdhjetë e rendit të ditës.

Projekt – vendim: "Për një saktësim në VKB Nr.64, datë.23/06/2025 të Këshillit të Bashkisë Fier "Për miratimin e tabelës me të dhënat e listës emërore të pronave dhe pronarëve , që do të shpronësohen për interes publik, për pasuritë e paluajtshme pronë private, që preken nga realizimi i projektit "Për zgjerimin e sheshit të stacionit zjarrfikës, të ndërtuar dhe financuar nga PNUD(UNDP), vlerësim paraprak me qëllim mbulimin e vlerës paraprake të shpronësimit për interes publik nga Buxheti i Bashkisë Fier, për vijimin e procedurave të shpronësimit për interes publik".

Znj.Antoneta Çunaj

Kush do të na i sqaroi këtë projekt vendim nga ana e administratës së bashkisë?Po Znj.Kapllanaj

Znj.Esmeralda Kapllanaj

Kjo procedurë është në vijim të procedurave të ndjekura me Agjensisë Shtetërore të Shpronësimit për miratimin e VKM-së dhe në kushtet kur shikohet nga komisioni teknik i vlerësimit mqs ky objekt ka një prerje dhe nuk shpronësohen tërësisht, është evidientuar një gabim që është bërë në përllogaritje midis projektit të zbatimit matjeve në terren dhe hedhjes në hartën kadastrale. Komisioni teknik ka vlerësuar në bazë të materialit që ka hartuar dhe vendimit përkatës , hartimit të hartës dhe plan vendosjes, dhe analiza që i ka bërë zërit të punimeve nga ana e konstruksionit dhe sipërfaqja do ti shtohet nga 50 m² në 77.5 m² ndërtesë si dhe sipërfaqja për m² e llogaritur gabim e pasurisë truall në 50 m² ku realisht kjo sipërfaqe evidentohet dhe saktësohet në 96 m² truall, pasi ky objekt siçe thamë dhe më lartë pritet nga ana e konstruksionit dhe është parë nga teknike dhe në momentin që do të prishet që të bëhet saktësimi i sipërfaqeve që do të shpronësohet.

Znj. Antoneta Çunaj

A ka ndonjëri ndonjë pyetje në lidhje me këtë projekt vendim?

Z.Ilia Fili

Kam unë një konstatim.Në mos gaboj kemi kaluar o një herë o dy herë në këshill të gjithë dëmshpërblimet e nevojshme për zonën për të cilën flitet, tani vjen dhe bëhet korrigjimi. Ky rast tregon domosdoshmërinë e shtimit të numrit të njerëzve në bashki, pra specialistëve, që mos të na vijnë më gabime të tilla në këshill.

Znj.Esmeralda Kapllanaj

Sa për sqarim të asaj që tha inxhinieri. Në këtë këshill bashkiak kanë kaluar dy project vendime. E para është ajo e realizimit të investimit që është realizuar nëpërmjet PNUD-it dhe e dyta është vendimi që kemi marrë për zgjerimin e sheshit të zjarrëfikses. Kërkesa e shpronësimit që po paraqesim ne sot, ka të bëj pikërisht me zgjerimin e sheshit të zjarrëfikses.

Znj. Antoneta Çunaj

A ka ndonjë tjetër pyetje? Jo atëherë e hedhim në votim. Kush është pro?

Pro 40 vota

13) 1

1

0 7

 \vee ι ι

Kundra 1 votë.

Abstenim s'ka.

Miratohet.

Pika e dymbëdhjetë e rendit të ditës.

Projekt–vendim: "Për miratimin e implementimit të Projektit Strategjik me titull ''ARIADNE'', në kuadër të Instrumentit të Para-Anëtarësimit (IPA III), Programi i Bashkëpunimit Ndërkufitar Greqi–Shqipëri 2021–2027."

Znj.Antoneta Çunaj

A është mbledhur komisioni përkatës për këtë projekt vendim?

Znj. Evis Sema

Edhe në rast se komisioni nuk është mbledhur të vazhdojmë me diskutimet.

Z.Ilia Fili

Zonja kryetare, ka një shprehje këtu "ndërkufitar" Çfarë kupton bashkia e Fierit me termin ndërkufitar?

Znj.Antoneta Çunaj

Tani do të ta sqarojë përfaqësuesja e bashkisë se përse është përdorur termi ndërkufitar këtu çfarë kuptojmë me të.

Znj. Sibora Qato

Në kuadër të programit ndërkufitar Greqi-Shqipëri, Bashkia Fier ka fituar projektin "Ariande", i cili do të parandalojë dhe do të përgatisë reagimin ndaj fatkeqësive si dhe forcimin e qëndrueshmërisë urbane. Ky projekt ka pesë partner, Bashkia Fier, Bashkia Tepelenë, Bashkia Janinë, Universiteti i Janinës dhe Bashkia Metsovo Greqi. Sot, Bashkia Fier propozon miratimin e implementimit të projektit të mësipër sepse bazuar në kushtet e aplikimit të projektit IPA të marrë përsipër mbulimin e kostos së bashkëfinancimit të projektit si dhe TVSH-së bazuar në buxhetin e palës Shqipëtare dhe përfshirjen e kësaj kostos dhe TVSH-së në buxhet. Buxheti për bashkinë Fier është 163.353,94 euro nga të cilat : 130.683,13 euro kontribut i BE-së dhe 32.670.81 euro bashkëfinancim i Bashkisë Fier

Znj. Antoneta Cunaj

Ka ndonjë diskutim tjetër në lidhje me këtë pikë?

V

Z.Endri Jaupaj

Duke u marrë me problemet e infrastrukturës, si ai i vizave të bardha apo i semaforëve që u diskutuan në mbledhjen e kaluar, na vjen një projekt këtu, pa u mbledhur këshilli, pa u diskutuar me specialistët e fushës, pa parë as edhe 1% të atij projekti, kërkohet dhe një shumë që për mendimin tim është e konsiderueshme, unë do ti lutesha këshilltarëve që ta votojnë kundra, sikur vetëm ajo pjesa jonë që kemi informacionin zero, që nga ju kryetare që nuk besoj se keni informacion edhe unë gjithashtu,çfarë ishte ky projekt ndërkufitar etje, unë propozoj që të votojmë kundra, për mungesën e transparnencës, për mungesën e specialistit që të

0/ -M 12 14 /1

na i shpjegojë, për mosshfaqjen në ledëoll të projektit, është një shumë e konsiderueshme që mund të përdorej kudo pasi ky qytet ka shumë nevojë sesa për projekte të tilla pa asnjë informacion.Kaq kisha.

Znj. Antoneta Çunaj

A ka diskutime të tjera?Jo.E hedhim në votim.Kushë është pro?

Pro 37 vota

Kundra 3 votë.

Abstenim 1 votë.

Miratohet.

Znj. Antoneta Çunaj

Pas publikimit të rendit të ditës, pas mbledhjes së kryesisë, që sikurse e dini bëhet 10 ditë përpara datës së zhvillimit të mbledhjes, e deri në afatin ligjor 5 ditor para mbledhjes, sikurse e thashë dhe në fillim të kësaj mbledhje, kanë ardhur edhe dy pika shtesë të cilat do ti diskutojmë tani

Pika e parë shtesë e rendit të ditës.

Projekt -vendim: "Për trajtimin me ndihmë shtetërore financiare të familjes së shtetasit Florjan Hoxhaj, lagjja "Liri Gero", Njësia Administrative nr.2, i dëmtuar nga zjarri i datës 13.09.2025.

Znj. Antoneta Çunaj

Për sa i përket pikës së parë shtesë të rendit të ditës, bëhet fjalë për një shtëpi të djegur nga zjarri të shtetasit Florjan Hoxha. Materiali ju ka ardhur brenda afatit ligjor dhe komisioni përkatës është mbledhur, është trajtuar. A ka ndonjë pyetje?Jo. e hedhim në votim. Kush është pro për pikën e parë shtesë të rendit të ditës?

Pro 41 vota

Kundra s'ka.

Abstenim s'ka.

Miratohet.

Pika e dytë shtesë e rendit të ditës.

"Për autorizimin e ekzekutivit të Bashkisë Fier të nënshkruaj marrëveshjen e bashkëpunimit për administrimin e përkohshëm të objektit "Depo uji 200 m³, Mbrostar Ura" nga "Shoqëria Rajonale e 'Ujësjellës-Kanalizime Fier' Sh.A.

Znj. Antoneta Çunaj

Kush do të flasi nga administrate e bashkisë që të japi sqarimet përkatëse në lidhje me këtë projekt vendim?

Znj. Eleni Gjikondaj

Në kuadër të invvestimeve që ka kryer Bashkia Fier gjatë vitit 2024, ka qënë dhe ndërtimi i depos së ujit. Mbas ndërtimit të depos së ujit, është bërë procesverbali i kolaudimit, është bërë procesverbali i marrjes së përkohëshme në dorëzim por nuk është kapur afati për dorëzimin përfundimtarë të saj. Në kuadër të faktit që ujësjellësi do ta marri në dorëzim në këto kushte, është bërë një marrëveshje me ujësjellësin që ata ta mbajnë



në administrim këtë depo uji, deri sa të çlirohet garancia dhe t'ja kalojmë si aset ujësjellësit. Kjo është gjithçka në lidhje me këtë projekt vendim.

Znj. Antoneta Çunaj

Ka diskutime në lidhje me këtë project vendim? Jo.E hedhim në votim. Kush është pro?

Pro 40 vota

Kundra 1 votë.

Abstenim s'ka.

Miratohet.

Pika e trembëdhjetë e rendit të ditës

Informacion Këshillit: "Mbi Raportin e Monitorimit për zbatimin e Buxhetit për 4 -mujorin e II-të të vitit 2025" të Bashkisë Fier".

Znj. Antoneta Çunaj

Kjo pikë e rendit të ditës është thjeshtë një informacion dhe nuk ka nevojë për vendim marrje nga ana jonë.

Me kaq mbledhjen e deklarojë të mbyllur. Ju falenderojë të gjithëve për pjesëmarrjen!

Ky procesverbal ka 16 (gjashtëmbëdhjetë) faqe dhe mbahet në tre kopje nga ana e Sekretarit të Këshillit Z. Arnando Çupa.

Sekretar i Këshillit

Arnando Cupa

Kryetar i Këshillit

Antoneta Cunai